

**RELACION**

**MBI MIRATIMIN E BUXHETITTE VITIT 2022**

**Të nderuar anëtarë të Asamblesë Kombëtare**

Viti 2020 si pasoje e pandemise të shkaktuar nga COVID 19, ka qenë një vit i vështirë, për ekonominë shqiptare në përgjithësi dhe për rrjedhojë dhe në sektorin e stomatologjisë ka patur problemet e saj. Megjithatë, mund të themi se gjatë vitit 2021 situata ka ndryshuar dhe ekonomia po shkon drejt normalizimit të saj.

Në këto kushte, viti 2022 do të jetë një sfidë për rruajtjen e qëndrueshmërisë së aktiviteteve ekonomike në përgjithësi, gjë e cila do të pasqyrohet edhe në buxhetin e çdo subjekti.

***BUXHETI I VITIT 2022***

***1. Objektivat e Buxhetit 2022***

Objektiv për buxhetin e vitit 2022 do të jetë qëndrueshmëria në rritjen e të ardhurave bruto dhe të ardhurave neto të vitit.

Kjo do të arrihet nëpërmjet tre rrugëve :

Së pari nga rritja e numrit të antarësisë si pasoje e prurjeve nga universitetet më shumë se dalja nga antarësi.

Së dyti nxitjen e pageses së të ardhurave ( kuotave ) nga të gjithë subjektet aktive dhe në mënyrë periodike dhe

Së treti për jo me pak e rëndësishme, përdorimin me efektivitet të të ardhurave

***2. Planifikimi i Buxheti për vitin 2022***

Hartimi i buxhetit të vitit 2022, si çdo vit tjetër, bazohet në përvojën e viteve paraardhëse, në buxhetet faktike të çdo viti, si për të ardhurat, ashtu dhe për shpenzimet si dhe në zbatimin e buxhetit në qendër, ashtu edhe nga Rajonet. Buxheti është planifikuar me 5% rritje krahasuar me vitin 2021, duke pasqyruar gjallërimin e aktivitetit ekonomik edhe në sektorin e stomatologjisë.

## 2.1 Planifikimi I te ardhurave

Si bazë për planifikimin e të ardhurave për vitin 2022 ka sherbyer ecuria e realizimit të të ardhura në vite dhe konkretisht :

- realizimi I të ardhurave për vitin 2021 si dhe I pritshmi deri në fund të vitit,
- realizimi I të ardhurave për vitet 2019- 2020
- numri licensimeve dhe rilicensimeve për periudhën e aktivitetit të Urdhrit, kryesisht atyre te licensuar gjatë vitit 2017, të cilët plotësojnë afatin e licensimit
- numri I stazhistëve të regjistruar për të qënë antarë të Urdhrit
- numri I stazhistëve të regjistruar për provimin e shtetit si dhe
- niveli mesatar I të ardhurave për cdo licensim, rilieensim apo kuotë vjetore.

Realizimi I të ardhurave për vitet 2015- tetor 2021 paraqitet si vijon:


NR	EMERTIMI	VITET					Viti 2020	Realizimi 10 mujor v.21
		VITI 2015	VITI 2016	VITI 2017	viti 2018	Viti 2019		
	<b>TE ARDHURAT</b>							
<b>I</b>	<b>TE ARDHURA NGA VEPRIMTARIA</b>							
1	Hapje dosje	3790	3580	3140	2930	2540	1960	2300
2	Licensim	2835	5355	4215	1740	3525	3075	2850
3	Rilicensim	2308	4020	6780	6735	5055	5582	6000
4	Kuote antaresimi	5049	19816	21644	22169	21705	30123	25670
	kuote nga licensimet		3739	2654	983	1853	1497	1547
	kuote nga Rilicensimet		6401	11036	13037	13660	16903	17730
	kuote vjetore		9676	7954	8149	6290	11783	5028
5	Certifikat miresjelljes	430	630	720	900	1020	1240	1120
6	Provimi praktikes	0	590	2560	2060	2780	2282	570
7	Trajnimi ONL	0	0	75	130	2	0	0
8	Drejtues Teknik	0	0	0	90	30	30	0
	Konferenca	0	0	0	0	426	132	710
9	te tjera	23	35	11	12	38	43	50
	<b>SHUMA I</b>	<b>14435</b>	<b>34026</b>	<b>39145</b>	<b>36766</b>	<b>36930</b>	<b>44467</b>	<b>37905</b>
<b>II</b>	<b>Ardhura te tjera</b>	<b>10000</b>			<b>182</b>	<b>0</b>		
	<b>TOTALI TE ARDHURAVE</b>	<b>24435</b>	<b>34026</b>	<b>39145</b>	<b>36948</b>	<b>37111</b>	<b>44467</b>	<b>37905</b>

Viti 2022 parashikohet me rritje të të ardhurave me rreth 5% më shumë se plani I vitit 2021 si dhe te jete me teprice kreditore prej 5920 mijë lekë.Parashikimi I të ardhurave për vitin 2022 do të jetë si vijon:

### PLANI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2022

NR	EMERTIMI	PLANI V. 2022 Në 000 lekë
1	KUOTA E ANTARESIMIT	27600
	LICENSIME	1600
	RILICENSIM	17000
	TE TJERA	9000
2	LICENSIM	3000
3	RILICENSIM	6600
4	HAPJE DOSJE	2300
5	PROVIM PRAKTIKES	2300
6	CERTIFIKAT MIRSJELLJE	1120
7	TRAJNIM ONL	0
8	DREJTUES TEKNIK	30
9	KONFERENCE	1000
10	TE TJERA	50
	<b>TOTALI</b>	<b>44000</b>

GrafikIsht realizimi I te ardhurave ne vite paraqitet si vijon:



Si shihet te ardhurat kane nje qendrushmeri ne vite te cilen jo vetem duhet ta konsolidojme, por te kemi nje trend rrites per te ardhmen. Te ardhurat jane planifikuar me lart se viti ne vazhdim duke u mbeshtetur ne nje


-detyrim statutor dhe ne

-vendimin e keshillit Kombetare per arketimin e **tarifave mujore** dhe jo me vone se nje vit nga data e detyrimit. Ne rast te kundert do te kete penalitete.

Nisur nga keto 2 detyrime ligjore, Aparati Qendror qe ne fund te vitit 2020 ka filluar punen per evidentimin e stomatologebve te cilet nuk paguajne detyrimet ritmikiisht.

Sic e theksuam dhe me lart, planifikimi I te ardhurave per vitin 2021 eshte mbeshtetur ne ecurine e tyre ne vite dhe nga numri I antareve qe kane kontribuar gjate periudhes.

Planifikimi I të ardhurave sipas peshes specifike te tyre, paraqitet si vijon:



Si shihet nga të dhënat peshen kryesore të të ardhurave e kanë të ardhurat nga kuotat e antarësimit, 63% të tyre, të cilat kanë një rritje prej 2% nga planifikimi I vitit 2021, me pas te ardhurat nga tarifa e rilicensimit 15% ose 2 % më shumë se plani vitit 2021.

Duke parë ecurinë e realizimit të të ardhurave në vite, për të mos planifikuar një buxhet fiktiv, si theksuam dhe më lart, të ardhurat në total janë parashikuar 5% me shume se parashikimi për vitit 2021, në shumën 44.000 mijë lekë . Realizimi I të ardhurave do të bëhet I mundur duke rritur bazën e antarëve që paguajnë detyrimet, duke evidentuar dhe monitoruar antarët që kanë vitin e rilicensimit dhe ata qe kane kaluar nje vit pa paguar detyrime si dhe duke formalizuar tregun e stomatologëve. Kjo do të arrihet me bashkëpunimin e të gjithëve, si të punonjësve të Aparatit Qendror, Sektorit Të liçensimit dhe Monitorimit, ashtu edhe të të zgjedhurve, në qendër dhe Rajone.

## 2.2. SHPENZIMET

Shpenzimet për vitin 2022 janë planifikuar në rritje krahasuar me vitin 2021. Kjo rritje është bazuar në Vendimin e Këshillit kombëtar për rritje të Investimeve në infrastrukturën e Urdhrit. Shpenzimet si çdo vit kanë karakter administrativ dhe shërbejnë për realizimin e misionit të Urdhrit nëpërmjet sektorëve të tij.


Shpenzimet janë planifikuar sipas strukture ekonomike si dhe sipas shpërndarjes gjeografike.

Realizimi I shpenzimeve në vite paraqitet sipas tabelës:

Në 000 lek0

B	SHPENZIMET	V. 2015	V. 2016	V. 2017	V. 2018	V. 2019	V. 2020
1	Pagat	5288	12028	13800	16049	16798	16397
2	Kontributi për sig shoq	784	1720	2038	2417	2387	2313
3	Shpenzime për honorare	1437	6149	4652	5086	5213	5649
4	Mallra e shërbime	1515	7821	7105	9332	9291	8495
5	Investime	1811	2100	4251	1277	397	439
6	F.Rezerve	0	100	644	118	0	
	<b>SHUMA</b>	<b>10835</b>	<b>29918</b>	<b>32490</b>	<b>34279</b>	<b>34086</b>	<b>33293</b>

Dhe në mënyrë grafike si vijon:



Siç vihet re dhe nga grafiku, shpenzimet kanë një trend të qëndrueshëm, pavarësisht se nga viti në vit shërbimet janë rritur, duke filluar me provimin e praktikës profesionale në vitin 2016 me një sezon, dhe në vitet në vazhdim me dy sezone, shërbimi I trajnimit ONL, rritja e sektorit të monitorimit dhe fillimi I konferencave informuese. Cdo shërbim që shtohet shoqërohet me kosto financiare, por duhet theksuar se rritja e shpenzimeve është me e ulët se rritja e të ardhurave, duke mos krijuar humbje për asnjë vit financiar.

Planifikimi I shpenzimeve për vitin 2022 sipas strukturës ekonomike paraqitet sipas tabelës:

Në 000 lekë

Nr	Emertimi	Shpenzime te shperndarane		Totali shpenzimeve
		<b>Qender</b>	<b>Qarqe</b>	
1	Paga, shperblime dhe te tjera shp personeli	18700	1507	20207
2	Fondi I vecante	935	75	1010
3	Kontribut sig shoqerore dhe shendetstore	3150	253	3403
4	shperblimet	1770	4700	6470
5	Mallra dhe sherbime te tjera	8000	1500	9500
6	INVESTIME	68710	0	68710
	SHUMA	101265	8035	109300
7	Fondi rezerve	800	200	1000
	TOTALI	102065	8235	110300

- Shpenzimet e personelit** të cilat janë përcaktuar sipas nr. të punonjësve të miratuar në Këshillin Kombëtar dhe funksioneve të tyre në strukturë. Në këtë zë përfshihen pagat, kontributi I sig. shoqërore e shëndetësore si dhe fondi I veçantë për punonjësit e Aparatit Qendror si dhe ne dy rajone.
- Shpenzimet operative** janë llogaritur për funksionimin normal të punës së administratës së Aparatit Qëndror dhe funksionimin e Rajoneve. Në këtë strukturë përfshihen shpenzimet për kanceleri, shtypshkrime, boj për printera, shpenzime për shërbime si energji, uje, telefoni, dieta, shpenzime financiare si qera, taksa, kuota pjesmarje në aktivitete etj. Ky zë është planifikuar 3% më shumë se viti 2021 aq sa parashikohet dhe inflacioni në buxhetit e shtetit për vitin 2022, por struktura e tyre analitike ndryshon duke ulur shpenzime per dieta, qera ambjente per aktivitete si dhe shpenzime pritje ne menyre te konsiderueshme, pasi do te kemi nje rritje ne shpenzime per ineres kredie.
- Shpenzimet për honorare**, ku përfshihen shpenzimet për shpërblime të antarëve të Këshillit Kombëtar e Keshillave Rajonal si dhe komisioneve të tyre, shpërblimin për antarët e Asamblese Kombëtare e bordit keshillmor sipas miratimit të masës së shpërblimit nga Këshilli Kombëtar.
- Investimet** per vitin 2022 jane planifikuar ne shume te konsiderueshme, ne zbatim te vendimit te keshillit kombetare per blerje ambjente per zyra per USSH Blerja e ambjenteve per zyra do të përballohet nga e ardhura neto e mbartur në vite si dhe me kredi bankare.Kredia do te levrohet sipas procedurave financiare dhe

parashikohet të shlyhet për një periudhe 15 vjecare. Gjithashtu në fondin për investime janë parashikuar fonde për programim te sistemit te kuotave, qe të bëjë të mundur çdo stomatolog të jet në dijeni per kontributin dhe detyrimeve të tij.

Plani I investimeve për vitin 2022 paraqitet si vijon:


#### PLANI I INVESTIMEVE PER VITIN 2022

Në 000 Lekë

nr	EMERTIMI	Fakti v.2017	Fakti v. 18	Fakti v. 19	Fakti v. 20	Fakti 10 mujor v.21	Plani v.2022
	pajisje zyre	4251	1127	397	439	383	500
	Programe					0	1110
	blerje zyra					0	67100
	<b>SHUMA ME TVSH</b>	<b>4251</b>	<b>1127</b>	<b>397</b>	<b>439</b>	<b>383</b>	<b>68710</b>

5. **Fondi rezervë**, I cili përcaktohet deri në 3% të shpenzimeve totale , dhe përdoret për shpenzime apo ngjarje të pa parashikuar dhe që mund të ndodhin gjatë vitit.Përdorimi I fondit rezervë do të bëhet me vendim të Këshillit Kombëtar.

Sipas strukturës te tyre shpenzimet ne menyre grafike paraqiten si vijon:



Ne ndryshim nga vitet paraardhese, peshën kryesore në strukturën e shpenzimeve e kanë shpenzimet kapitale 62 % e cila lidhet me investimin madhor qe do të realizohet me blerjen e ambjenteve per zyra per Aparatin Qendror dhe Rajonin Tirane.

Plani I buxhetit per vitin 2022 paraqitet sipas tabelës vijuese:

<b>BUXHETI I VITIT 2022</b>		
<b>Nr</b>	<b>Emertimi</b>	<b>SHUMA ne 000 leke</b>
<b>I</b>	<b>TE ARDHURA GJITHSEJ v.2022</b>	<b>44000</b>
1	Kuota e antaresimit	27600
2	Licensim	3000
3	Rilicensim	6600
4	Regjistrime te reja ( hapje dosje)	2300
5	Provim praktikes	2300
6	Certifikat mirsjellje	1120
7	Trajnim ONL	0
8	Drejtues Teknik	30
9	Konference	1000
10	Te tjera	50
<b>II</b>	<b>Te ardhura te trasheguara deri 31.12.2020</b>	<b>41720</b>
<b>III</b>	<b>Kredi Bankare</b>	<b>30500</b>
	<b>Totali te ardhurave I+II+III</b>	<b>116220</b>
<b>IV</b>	<b>SHPENZIME GJITHSEJ</b>	<b>110300</b>
<b>1</b>	Paga, shperblime dhe te tjera shp personeli	20207
<b>2</b>	Fondi I vecante	1010
<b>3</b>	Kontribut sig shoqerore dhe shendetsore	3403
<b>4</b>	shperblimet ( Honorare)	6470
<b>5</b>	Mallra e shpenzime te tjera	9500
<b>6</b>	Investime	68710
	<b>SHUMA</b>	<b>109300</b>
7	Fondi rezerve	1000
<b>V</b>	<b>TEPRICA QE MBARTET</b>	<b>5920</b>

### *2.3 Detajimi i Buxhetit të vitit 2022 sipas njesive administrative*

**Planifikimi I buxhetit sipas rajoneve është bazuar në këta faktorë:**

- Detajimi dhe realizimi I buxhetit në vite nga Rajonet
- Struktura organizative e tyre sipas miratimit në Këshillin Kombëtar
- Zhvillimi I aktivitetit vendimarrës të këshillave rajonal
- Funksionimi I komisioneve disiplinore
- Perdorimi I fondeve të planifikuar per mallra e sherbime



Detajimi I buxhetit per vitin 2022 sipas ndarjes administrative do të mbetet pothuaj në nivelet e vitit 2021 dhe do te jete si vijon

Nr	Emertimi	SHUMA ne 000 leke
	<b>SHPENZIME GJITHSEJ</b>	<b>110300</b>
1	Aparati qendror	102065
2	Keshilli Rajonal Tirane	2270
3	Keshilli Rajonal Durres	1050
4	Keshilli Rajonal Fier	980
5	Keshilli Rajonal Elbasan	990
6	Keshilli Rajonal Vlore	980
7	Keshilli Rajonal Lezhe	980
8	Keshilli Rajonal Shkoder	985

Struktura e shpenzimeve te Rajoneve sipas struktures ekonomike detajohet :

- honorare per Presidentet e rajoneve, sekretaret e tyre, keshillat rajonal si dhe komisioneve disiplinore.
- Paga për sekretaret e keshillave te emeruar rajonet Tirane dhe Durres
- Shpenzimet per blerje mallra e shërbime për shërbime administrative si dhe
- Fondi rezerve

Në zbatim të Ligjit nr.127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut” , rajonet do të miratojnë detajimin e mëtejshëm të buxhetit në Këshillat e tyre rajonal. Vendimi I miratimit të Buxhetit të vitit 2022 nga Këshillat Rajonal do të depozitohet në Aparatin Qendror për ndjekje të realizimit të Tij. Nuk do të likujdohen shpenzime operative te Rajoneve nëse nuk miratohen nga këshillat e tyre.

Buxheti rajonal është vjetor dhe nuk mbartet për vitin tjetër.

### 3. Te tjera

Teprica e buxhetit faktik te Urdhrit do të mbartet ne tepricën e viteve të mëparshme **Zbatimi I buxhetit** do të bëhet sipas legjislacionit financiar në fuqi, Ligjit nr.127/2014 “Për Urdhrin e Stomatologut”, statutit të USSH-së dhe Urdhrave dhe Udhezimeve të Presidentit të Urdhrit.

**Arkëtimet** do të vazhdojnë të bëhen vetëm nëpërmjet sistemit bankar, I vërtetuar me konfirmën bankare.

**Shpenzimet** do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara dhe të mbështetur në dokumenta standarte të miratuara për financat dhe për kontabilitetin. Procedurat do të zbatohen nga administrata qendrore dhe lokale, përkatësisht për buxhetin Qendror dhe Rajonal.

Ndjekja e zbatimit të Buxhetit do të bëhet nga Aparati Qendror I Urdhrit dhe transfertat do të bëhen nën siglen e Presidentit të Urdhrit, i cili njihet si person juridik dhe është i regjistruar në organet tatimore si përfaqësues i Urdhrit si dhe P/Sektorit Ekonomik si firmë e dytë.

Për detajimin e metejshëm të buxhetit në mënyrë analitike dhe zbatimin e tij, **autorizohen Presidenti I Urdhrit dhe Presidentët e Rajoneve** përkatësisht për buxhetin qendror dhe buxhetet respektive rajonale.

Gjithë dokumentacioni për shpenzimet që do të realizohen do të depozitohet në sektorin Ekonomik për likuidim.

Keto ishin treguesit e buxhetit të vitit 2022.

Mendoj se treguesit e tij do të jenë realë dhe të realizueshëm . Gjatë vitit 2022 do të punohet për arketimin dhe miradministrimin sa më të mirë të tij dhe me efektivitet.

Ju ftoj të gjithëve për miratimin e Buxhetit të vitit 2022.

**P/SEKTORIT EKONOMIK**

**Natasha DHRAMI**

